

**Miratohet**

**Dekani**

**Prof. Dr. Dhori Kule**

**PROPOZIM PËR HAPJEN DHE ORGANIZIMIN E  
PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT**

**Master Shkencor në MENAXHIM RISKU**

**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I EKONOMISË**  
**DEPARTAMENTI I FINANCËS**

**PROPOZIM PËR HAPJEN DHE ORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË  
DYTË TË STUDIMIT**

**Master Shkencor në MENAXHIM RISKU**

**1. Argumentimi pse propozohet të hapet programi Master Shkencor në Menaxhim Risku**

Mjedisi i sotëm i biznesit është shumë kompleks e sfidues dhe karakterizohet nga risku, pasiguria dhe ritme shumë të shpejta ndryshimi. Krizat financiare kanë detyruar organizatat të ndryshojnë modelet e tyre të biznesit, sistemet e informacionit dhe proceset e menaxhimit për të përmirësuar performancën dhe për të menaxhuar risqet. Në kushtet e globalizimit dhe sfidave të reja, edhe në Shqipëri, organizatat me qëllim që të funksionojnë mirë nuk bazohen më vetëm në parashikim, por fokusi i tyre tashmë është përtërirë dhe ai është menaxhimi i riskut.

Risku është shkak kryesor i pasigurisë në çdo organizatë. Kështu, kompanitë gjithnjë e më shumë fokusohen në identifikimin e risqeve dhe menaxhimin e tyre para se ato të ndikojnë në biznes. Aftësia për të menaxhuar riskun do të ndihmojë organizatat të veprojnë më me besim në vendimet e ardhshme të tyre. Njohuritë e tyre për risqet me të cilat përballen do t'u japin mundësi të ndryshme se si të përballen me problemet e mundshme në të ardhmen.

Në vitet e fundit, shumë kompani kanë krijuar departamentet e menaxhimit të riskut në strukturën e tyre. Roli i tyre është të identifikojnë risqet, të krijojnë strategji për t'u mbrojtur nga këto risqe, të zbatojnë këto strategji dhe të motivojnë të gjithë anëtarët e kompanisë që të bashkëpunojnë në këto strategji. Gjithashtu, ekipi i menaxhimit të riskut është përgjegjës për vlerësimin e secilit risk dhe përcaktimin se cilat prej tyre janë kritike për biznesin. Qëllimi i përgjithshëm i menaxhimit të riskut është që të sigurohet që kompania merr vetëm risqe që do të ndihmojnë në arritjen e objektivave të saj parësore, duke i mbajtur të gjitha risqet e tjera nën kontroll.

Në kushtet kur tregu është i orientuar drejt kërkesave për profesionistë shumë specifikë, lind nevoja që Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, të përshtatet me nevojat e tregut dhe të përgatisë studentë në funksion të tyre. Aktualisht, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, ofron studime master shkencor dhe profesional në dy drejtime të veçanta: 1. në Financë; 2. në Kontabilitet dhe Auditim. Nisur nga zhvillimet e tregut, si dhe kërkesat e shumë kompanive, institucioneve publike, institucioneve financiare të cilat kanë shprehur kërkesën për staf të kualifikuar në fushën e menaxhimit të riskut është domosdoshmëri çelja e këtij programi të ri studimi Master që të jetë i orientuar në ofrimin e njohurive të kërkuara nga tregu i punës. Për këtë arsye, sugjerojmë krijimin e një Masteri të ri Shkencor në Menaxhim Risku.

Me qëllim studimin e tregut dhe analizës së këndvështrimeve të ekspertëve shqiptarë të fushës së menaxhimit të riskut mbi organizimin e studimeve master në këtë fushë dhe përmbatjes së mundshme të tyre, gjatë periudhës mars-prill 2017, Departamenti i Financës, i Fakultetit të Ekonomisë së Universitetit të Tiranës ka kryer disa intervista me ekspertë të fushës, profesionistë që punojnë në fushën e menaxhimit të riskut financiar, të menaxhimit të riskut të ndërmarrjeve dhe

menaxhimit të riskut të katastrofave dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare përgjegjëse për mbrojtjen civile. Rezultati i këtij procesi ka qenë një kuptim i plotë i problemeve me të cilat Shqipëria përballet në lidhje me nevojat e arsimit në fushën e drejtimit të riskut. Rezultatet e këtij studimi tregojnë që është i nevojshëm një kontribut më i madh në fushën e edukimit mbi menaxhimin e riskut financiar, të ndërmarrjes dhe riskut të katastrofave, dhe zhvillimi i kurrikulave në universitete për këtë qëllim është një hap i domosdoshëm drejt krijimit të kapaciteteve në këtë fushë. Ky përfundim është mbështetur fuqishëm nga pjesëmarrësit gjatë intervistave të zhvilluara, veçanërisht nga përfaqësuesit e institucioneve kërkimore, përfaqësuesit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare, drejtues të institucioneve financiare bankare dhe jo bankare në Shqipëri, si edhe nga ekspertët dhe hulumtuesit e fushës së menaxhimit të riskut të katastrofave, si përfaqësues të PNUD-it, Institutit të Kërkimit të Ujërave, projektit IBECA, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Brendshme, dhe Bashkisë së Tiranës. Një pasqyre e intervistave të zhvilluara dhe rezultateve të këtij procesi paraqitet në vijim.

<p><b><i>Institucioni ku është zhvilluar intervista:</i></b> Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare</p> <p><b><i>Personi/personat e kontaktuar:</i></b> Zj. Ornela Kullolli; Z. Aranit Mujo</p> <p><b><i>Rezultatet kryesore:</i></b> Gjatë takimit u diskutua rreth rëndësisë së zhvillimit të një fushe të re studimesh në menaxhimin e riskut. U diskutuan mbi nevojat e tregut dhe veçanërisht të institucioneve financiare për ekspertë të mirëfilltë të fushës së menaxhimit të riskut. Këto përfundime u mbështetën fuqishëm nga përfaqësuesit e Autoritetit. U shpreh nga të dyja palët vullneti dhe dëshira për një bashkëpunim të mundshëm në kuadër të programit të ri master, me idenë e zhvillimit të leksioneve dhe trajnimeve të përbashkëta për studentët e masterit. Gjithashtu u diskutua angazhimi potencial i disa përfaqësuesve të Autoritetit në mësimdhënie. Pas hartimit të draft-it të programit nga ana e Departamentit, u diskutua në mënyrë të detajuar mbi përmbajtjen e kurrikulën dhe orientimit të saj teorik dhe praktik.</p>
<p><b><i>Institucioni ku është zhvilluar intervista:</i></b> Alpha Bank</p> <p><b><i>Personi/personat e kontaktuar:</i></b> Prof.Dr. Orfea Dhuci</p> <p><b><i>Rezultatet kryesore:</i></b> Gjatë takimit u diskutua mbi përmbajtjen e kurrikulës së masterit të ri në menaxhimin e riskut. Në veçanti u diskutua integrimi i tre fushave të menaxhimit të riskut në programin e ri master: menaxhimi i riskut të ndërmarrjes; menaxhimi i riskut financiar; menaxhimi i riskut të katastrofave. U shqyrtua përmbajtja e lëndëve kryesore dhe orientimit të tyre teorik dhe praktik.</p>
<p><b><i>Institucioni ku është zhvilluar intervista:</i></b> Qendra rajonale mjedisore</p> <p><b><i>Personi/personat e kontaktuar:</i></b> Z. Eduart Cani</p> <p><b><i>Rezultatet kryesore:</i></b> Gjatë takimit u diskutua mbi një nga shtyllat e programit të ri master, atë të menaxhimit të riskut të katastrofave. Z. Cani përshkroi projektet aktuale që po zbatohen në këtë fushë në Shqipëri, dhe diskutoi mbi nevojat e ofrimit të studimeve që adresojnë çështjet e financimit të kostove të katastrofave dhe metodave sasore të llogaritjes së riskut dhe kostove të këtyre ngjarjeve ekstreme. U adresua në veçanti mungesave e studimeve dhe njohurive të mirëfillta të zhvilluara brenda vendit në lidhje me çështjet e financimit dhe vlerësimit të riskut të katastrofave.</p>
<p><b><i>Institucionet ku janë zhvilluar intervistat:</i></b> Drejtoria e Emergjencave Civile; Bashkia e Tiranës; PNUD; Ministria e Bujqësisë; Projekti IBECA</p> <p><b><i>Personi/personat e kontaktuar:</i></b> Z. Maksimilian Dhima; Z. Ruzhdi. Baxhaku; Zj. Mirela Kamberi; Zj. Eglantina Bruçi; Z. Arben Pambuku; Zj. Narin Panariti</p> <p><b><i>Rezultatet kryesore:</i></b> Qëllimi i kësaj serie intervistash ishte njohja me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e situatës në rast emergjencash, si dhe me institucionet që mbështesin këtë proces, në fushën e kërkimit si edhe në fushën e hartimit të legjislacionit mjedisor. Gjatë këtyre takimeve pjesëmarrësve ju paraqit ideja e krijimit të masterit të ri dhe përmbajtja e tij, veçanërisht në drejtim të shtyllës së tretë të programit, atë të menaxhimit të riskut të katastrofave. Idea e krijimit të këtij</p>

programi dhe përmbajtjes specifike të tij u aprovua nga të gjithë pjesëmarrësit dhe u shpreh edhe kërkesa për trajnim të stafit aktual të disa prej institucioneve në drejtim të përfundimit të njohurive për financimin e qëndrueshëm të kostove në rast fatkeqësish dhe vlerësimit sasior dhe modelimit të riskut të katastrofave në Shqipëri. Me pjesëmarrësit u diskutua përmbajtja e lëndëve specifike të fushës, por edhe të lëndëve të tjera që do të ofrojnë programit, dhe u vlerësua nga pjesëmarrësit që integrimi i subjekteve dhe drejtimeve të menaxhimit të riskut është një risi në fushën e edukimit dhe një domosdoshmëri në kushtet aktuale ekonomike të vendit.

Për çeljen e këtij programi studimi, Departamenti i Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës është mbështetur gjithashtu tek përvojat më të mira të disa universiteteve të huaja të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi. Mbështetur në një bashkëpunim në kuadër të Programit të Edukimit Erasmus +, Universiteti i Tiranës që prej vitit 2016 është partner në Projektin K-Force. Projekti po zhvillohet nëpërmjet bashkëpunimit të 12 partnerëve akademikë, dhe 4 partnerëve jo-akademikë. Drejtues i këtij projekti është Universiteti i Novi Sad-it (Serbi). Partnerë të tjerë akademikë përfshijnë Universitetin e Lundit (Suedi), Universitetin e Aalborgut dhe Universitetin Teknik të Danimarkës (Danimarkë), Universitetin e Zilinës (Sllovaki), Universitetin e Shkupit (Maqedoni), Shkollën e Lartë Teknike të Novi Sadit (Serbi), Universitetin e Banja Lukës dhe Universitetin e Tuzlës (Bosnje-Hercegovinë), Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Epoka (Shqipëri). Njohuritë e fituara në kuadër të këtij projekti në fushën e Menaxhimit të Riskut do të sigurojnë një mbështetje të rëndësishme në iniciativën e hapjes së programit të ri të propozuar.

Ky program do të ofrojë një sistem të gjerë të njohurive në financa dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit të riskut, me objektivin kryesor të formimit të specialistëve të aftë për të ushtruar profesionin e analistit të riskut në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Kurrikula e programit përgatit studentin me të gjitha aftësitë e nevojshme si një analist i riskut me një nivel të lartë të njohurive shkencore teorike dhe njohurive praktike, si dhe njohuri të thella në analizat sasiore. Ky program dyvjeçar i studimit, në fokusin e tij të plotë, kombinon njohuritë teorike dhe praktike për të inkurajuar të menduarin në mënyrë kritike dhe krijuese për studentët, si dhe për t'i ekspozuar ata në çështjet bashkëkohore dhe kyçe në fushën e menaxhimit të riskut. Programi Master synon të kombinojë tri qasje në menaxhimin e riskut: menaxhimin e riskut të ndërmarrjeve; menaxhimin e riskut financiar; dhe menaxhimin e riskut nga katastrofat. Në vitet e para, ky program master do të ofrohet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë në kuadër të projektit K-Force dhe studentëve do t'u ofrohet mundësia për të zhvilluar shkëmbime në universitetet e Ballkanit Perëndimor për një periudhë pese mujore. Në të njëjtën kohë, lëndë të ndryshme do të organizohen drejt ofrimit të leksioneve të përbashkëta në bashkëpunim me partnerët e projektit dhe ekspertë të tjerë në terren që ushtrojnë profesionin e tyre në institucione të rëndësishme në Shqipëri.

## **2. Objektivat formuese të programit të studimit**

### ***Qëllimi i programit të studimit:***

Masteri Shkencor në Menaxhim Risku targeton nevojat e reja të tregut dhe synon të ndërthurë njohuritë në fushën e menaxhimit të riskut në tre drejtime kryesore: menaxhimi i riskut të ndërmarrjes, menaxhimi i riskut financiar dhe menaxhimi i riskut të katastrofave. Masteri do të zhvillohet si bashkëpunim i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe universiteteve partnere të Projektit K-Force i financuar nga Bashkimi Evropian. Partnerët e projektit janë universitete nga rajoni i Ballkanit si dhe Universitete të Evropës Perëndimore, duke përfshirë: Universitetin e Lundit (Suedi), Universitetin e Aalborgut dhe Universitetin Teknik të Danimarkës (Danimarkë), Universitetin e Zilinës (Sllovaki), Universitetin e Shkupit (Maqedoni), Universitetin e

Novi Sad-it (Serbi), Shkollën e Lartë Teknike të Novi Sadit (Serbi), Universitetin e Banja Lukës dhe Universitetin e Tuzlës (Bosnje-Hercegovine), Universiteti Epoka (Shqipëri).

Ky program do të ofrojë një sistem të gjerë të njohurive në financë dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit të riskut, me objektivin kryesor të formimit të specialistëve të aftë për të ushtruar profesionin e analistit të riskut në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Kurrikula e programit përgatit studentin me të gjitha aftësitë e nevojshme si një analist i riskut me një nivel të lartë të njohurive shkencore teorike dhe njohurive praktike, si dhe njohuri të thella në analizat sasiore.

Kjo diplomë do të mundësojë që studentët e diplomuar të këtij programi të studimit të punësohen në institucionet e nivelit qendror dhe lokal, institucionet kërkimore, institucionet financiare, entitetet, kompanitë (publike ose private), shoqatat e ndryshme etj. si specialist në fushën përkatëse të studimit ose në rolin e menaxherit të riskut. Gjithashtu përfundimi i suksesshëm i këtij programi studimi u mundëson studentëve të ndjekin në mënyrë koherente një karrierë kërkimore ose akademike përmes ndjekjes në vazhdim të studimeve të doktoraturës, duke rritur kështu mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale.

**Objektivat e programit të studimit:**

Në përfundim të programit të studimit, studenti do të jetë i aftë të shprehë kualifikimet e mëposhtme:

- njohuri në fushën e menaxhimit të riskut që plotëson njohuritë e fituara në studimet akademike universitare, duke qenë baza për zhvillimin e mendimit kritik dhe aplikimit të njohurive;
- aftësi për të aplikuar njohuri në zgjidhjen e problemeve në një mjedisi të ri ose të panjohur;
- aftësi për të integruar njohuritë, për të zgjidhur probleme komplekse dhe për të marrë vendime bazuar në informacionin në dispozicion duke marrë parasysh përgjegjësitë shoqërore dhe etike në lidhje me zbatimin e njohurive dhe gjykimeve të tyre;
- aftësi për të transferuar në mënyrë të qartë dhe pa dyshim njohuritë dhe mënyrën e nxjerrjes së konkluzioneve tek publiku profesional dhe më i gjerë;
- aftësi për të vazhduar studimet në mënyrë të pavarur në të ardhmen.

**4. Përshkrimi i programit të studimit**

**Emërtimi i përgjithshëm i programit të studimit:** Master Shkencor në Menaxhim Risku

**Kohëzgjatja e programit të studimit:** 2 vite akademike/4 Semestra

**Kreditet totale:** 120 ECTS

**Forma e studimit:** Me kohë të plotë

Në Tabelën 1 paraqitet një informacion i përmbledhur mbi disiplinat dhe kreditet e nevojshme për çdo fushë disiplinore sipas tipeve të veprimtarisë.

**Tabela 1.** Kreditet për çdo fushë disiplinore sipas tipit të veprimtarisë

Tipi i veprimtarisë dhe simboli përcaktues	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera	Orë Mësimore	Kredite	Totali i krediteve
Disiplina të formimit të përgjithshëm ( <i>Simboli A</i> )	1. Bazat e vlerësimit të riskut dhe vendimmarrja	60	6	12

	2. Metoda Kërkimi	60	6	
Disiplina të formimit karakterizues ( <i>Simboli B</i> )	1. Menaxhimi i riskut të ndërmarrjes	60	6	47
	2. Parashikimi dhe vlerësimi financiar	60	6	
	3. Menaxhimi i riskut të katastrofave	60	6	
	4. Probabiliteti në menaxhimin e riskut	60	6	
	5. Menaxhimi i riskut dhe sigurimet	60	6	
	6. Menaxhimi i riskut në banka	60	6	
	7. Auditim me bazë risku	60	6	
	8. Modelimi i riskut në praktikë	60	5	
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese ( <i>Simboli C</i> )	1. Ekonometri	60	6	11
	2. Ekonomiks zhvillimi	60	5	
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët, ndërmjet atyre që ofron institucioni ( <i>Simboli D</i> )	1. Menaxhimi i riskut në sistemet e informacionit	60	5	15
	2. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	60	5	
	3. Tregjet e energjisë	60	5	
	4. Logjistikë dhe menaxhim operacionesh	60	5	
	5. Vlerësimi pasurive të paluajtshme	60	5	
	6. Siguria dhe shëndeti në punë	60	5	
Veprimtari formuese, si praktika, mikroteza ( <i>Simboli E &amp; F</i> )	1. Praktika	100	5	35
	2. Mikroteza	150	30	
		<b>1150</b>	<b>120</b>	<b>120</b>

Për realizimin e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Risku janë parashikuar metodat e mëposhtme të mësimdhënies:

- Leksione interaktive;
- Seminare/Ushtime;
- Projekte/Detyrë kursi;
- Praktikë profesionale;
- Punë në grup;
- Detyra në laborator (përdorim software-sh dhe sistemesh kompjuterike);
- Ese dhe shkrim artikujsh analitik.

Përveç metodës klasike të mësimdhënies e cila kërkon prezencën e studentëve në klasë, në procesin e mësimdhënies në programin e studimit Master Shkencor në Menaxhim Risku do të përdoren edhe metoda të tjera fleksibile të mësimdhënies. Për të gjitha lëndët do të ofrohen materiale në formë digjitale, të disponueshme online, nëpërmjet sistemeve të informacionit të vëna në dispozicion të studentëve.

## 5. Kritere specifike të pranimit të studentëve në program

### 5.1. Diploma e ciklit të parë

Programet e studimit të ciklit të parë që mundësojnë pranimin në programin e studimit të ciklit të dytë janë të specifikuar si më poshtë.

a) *pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:*

<b>Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë</b>	
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	<ul style="list-style-type: none"><li>• Bachelor në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.</li><li>• Diplomë e sistemit të vjetër (4 vjeçar) në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.</li></ul>
<b>Nga institucione të tjera të arsimit të lartë</b>	
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	Nuk ka

b) *me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:*

<b>Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë</b>	
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese para hyrjes në program	<ul style="list-style-type: none"><li>• Bachelor në Administrim-Biznes, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.</li><li>• Bachelor në Ekonomiks, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.</li></ul>
<b>Nga institucione të tjera të arsimit të lartë</b>	
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese para hyrjes në program	<ul style="list-style-type: none"><li>• Bachelor në Financë-Kontabilitet të Fakulteteve të Ekonomisë të shkollave publike dhe jo publike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.</li><li>• Bachelor në Administrim-Biznes të Fakulteteve të Ekonomisë të shkollave publike dhe jo publike, vendase e të huaja, pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.</li></ul>

### 5.2. Nota mesatare e ciklit të parë

Nota mesatare e ciklit të parë e vlefshme si kriter pranimi në programin e ri të studimeve do të jetë e përcaktuar sipas udhëzimeve të Ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi në vitin akademik të fillimit të masterit.

### 5.3. Gjuha e huaj

Kriteret për njohje të gjuhës së huaj do të përcaktohen mbi bazën e udhëzimeve të Ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi në vitin akademik të fillimit të masterit.

### 5.4. Numri i studentëve

Numri maksimal i propozuar i studentëve që do të pranohen në program është 30. Numri minimal i

studentëve për hapjen e programit është 20.

### 5.5. Mundësitë e transferimit të studentëve ndërmjet programeve të studimit të ciklit të dytë

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës ofron mundësi për transferim studimesh në këtë program studimi për studentët që ndjekin programe të njëjta apo të ngjashme, sipas përcaktimeve të akteve normative të universitetit dhe fakultetit për këtë aspekt.

### 6. Personeli akademik për realizimin e programit

Për realizimin e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Risku do të angazhohet personeli akademik efektiv, si dhe ai me kohë të pjesshme, i Departamentit të Financës , si dhe pedagogë nga departamente të tjerë të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (Departamenti i Kontabilitetit, Departamenti Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar, Departamenti Menaxhim, Departamenti Ekonomiksit). Gjithashtu do të angazhohen pedagogë të huaj sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara në kudër të projektit K-Force. Së fundi, do të angazhohet staf i kualifikuar i institucioneve me të cilat do të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi, bashkëpunim i cili do të ofrojë një vlerë të shtuar në mësimdhënie duke kombinuar profesionalizmin me praktikat konkrete të aplikuara në fushën e menaxhimit të riskut. Në tabelën 2 paraqitet një informacion i përmbledhur mbi strukturat akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese në programin e ri të studimit

**Tabela 2:** *Strukturat akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese*

Fakulteti apo një strukturë tjetër didaktike (struktura përgjegjëse)	Departamenti i Financës (FEUT)
Struktura të tjera bashkëpunuese	Departamenti i Ekonomiksit (FEUT) Departamenti i Statistikës së Zbatuar dhe Informatikës (FEUT) Departamenti i Kontabilitetit (FEUT) Departamenti i Menaxhimit (FEUT) Universiteti Epoka
Institucione të huaja të arsimit të lartë ose Qendra të huaja kërkimore	Universiteti i Lundit (Suedi), Universiteti i Aalborgut dhe Universiteti Teknik i Danimarkës (Danimarkë), Universiteti i Zilinës (Sllovaki), Universiteti i Shkupit (Maqedoni), Universiteti i Novi Sad-it dhe Shkolla e Lartë Teknike e Novi Sadit (Serbi), Universiteti i Banja Lukës dhe Universiteti i Tuzlës (Bosnje-Hercegovinë)
Subjekte të tjera publike apo private	Qendra Rajonale e Mjedisit (Shqipëri) Programi i UNDP për ndryshimet klimatike Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare Drejtoria e Emergjencave civile Bashkia e Tiranës



Në tabelën 3 paraqitet lista e pedagogëve të parashikuar në procesin e mësimdhënies.

**Tabela 3.** *Lista e pedagogëve të parashikuar në mësimdhënie*

<b>Personeli akademik (me kohë të plotë/të pjeshme)</b>	<b>Titulli apo grada shkencore</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Departamenti</b>	<b>Spektori mësimor- kërkimor</b>	<b>Kontrata e punës</b>
Edlira Luçi	Prof. Asoc. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Halit Xhafa	Prof. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Vjollca Karapici	Prof. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Kontabilitet	Kontabilitet	Kohë e plotë
Kozeta Sevrani	Prof. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Statistikës së Zbatuar dhe i Informatikës	Informatikë	Kohë e plotë
Arben Malaj	Prof. Dr.	Universiteti Luarasi	Fakulteti Ekonomik	Ekonomiks	Kohë e pjeshme
Eglantina Bruçi	Prof.Dr.	Program i Ndryshimeve Klimatike, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PKBZh)	Koordinator Teknik për cënueshmërinë dhe përshtatjen	Menaxhimi i riskut të katastrofave natyrore, Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	Kohë e pjeshme
Orfea Dhuci	Prof. Asoc. Dr.	Alpha Bank	Këshilltar Ekonomik	Financë	Kohë e pjeshme
Gentiana Sharku	Prof. Asoc. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Brikena Leka	Prof. Asoc. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Etleva Bajrami	Prof. Asoc. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Dorina Kripa	Prof. Asoc. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Arjan Qefalia	Prof. Asoc. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Menaxhimit	Menaxhim	Kohë e plotë
Valentina Sinaj	Prof. Asoc. Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Statistikës së Zbatuar dhe i Informatikës	Statistikë	Kohë e plotë
Alban Korbi	Doc/Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Perseta Grabova	Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Elona Pojani	Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë

Dorina Janku	Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Egerta Marku	Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Matilda Tola	Dr.	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Departamenti i Financës	Financë	Kohë e plotë
Kleida Haxhi	Dr.	Universiteti Politeknik- Tiranë Fakulteti i Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike	Departamenti i Inxhinierisë Matematike	Inxhinieri Matematike	Kohë e pjesshme
Aranit Muja	Dr.	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Shqipëri	Aktuar	Probabilitet	Kohë e pjesshme
Ilir Alimehmeti	Dr.	Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri	Departamenti i Mjekësisë së Familjes dhe Sëmundjeve Profesionale,	Mjekësi e Familjes dhe Sëmundjeve Profesionale,	Kohë e pjesshme
Eduart Cani	MSc.	Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) - Shqipëri	Ekspert i lartë	Menaxhimi i riskut të katastrofave natyrore	Kohë e pjesshme

## 7. Plani mësimor

Në tabelën 4 paraqitet plani mësimor i programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Risku sipas disiplinave mësimore për çdo semestër.

Nr	Lëndët	Ngarkesa e lëndëve/ veprimtarive formuese								Ngarkesa mësimore sipas semestrave					
		A-F	ECTS	Orë audit/Gjithsej	Leksione/kredite	Seminar/kredite	ushtrime/kredite	Praktika/kredite	Orë jashtë audit	Semestri I/15 javë			Semestri II/15 javë		
										Leksione	Seminar	ushtrime	Leksione	Seminar	ushtrime
<b>Viti i parë</b>															
1.	Bazat e vlerësimit të riskut dhe vendimmarrja	A	6	60	30/3	15/2	15/1		90	2	1	1			
2.	Menaxhimi i riskut të ndërmarrjes	B	6	60	30/3	15/2	15/1		90	2	1	1			
3.	Ekonometri	C	6	60	30/3	15/2	15/1		90	2	1	1			
4.	Parashikimi dhe vlerësimi financiar	B	6	60	30/3	15/2	15/1		90	2	1	1			
5.	Metoda Kërkimi	A	6	60	30/3	15/2	15/1		90	2	1	1			
6.	Menaxhimi i riskut të katastrofave	B	6	60	30/3	15/2	15/1		90				2	1	1
7.	Probabiliteti në menaxhimin e riskut	B	6	60	30/3	15/2	15/1		90				2	1	1
8.	Menaxhimi i riskut dhe sigurimet	B	6	60	30/3	15/2	15/1		90				2	1	1
9.	Ekonomiks zhvillimi	C	5	60	30/3		30/2		65				2		2
10.	Menaxhimi i riskut në banka	B	6	60	30/3	15/2	15/1		90				2	1	1
<b>Gjithsej viti i parë</b>			<b>59</b>	<b>600</b>	<b>300</b>	<b>135</b>	<b>165</b>		<b>875</b>						
<b>Viti i dytë</b>															
1.	Auditim me bazë risku	B	6	60	30/3	15/2	15/1		90	2	1	1			
2.	Modelimi i riskut në praktikë	B	5	60	30/3		30/2		65	2		2			
3.	<b>Lëndë me zgjedhje</b> (stud. zgjedh 3 lëndë nga 6)	D	15												
	Menaxhimi i riskut në sistemet e informacionit	D	5	60	30/3		30/2		65						
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	D	5	60	30/3		30/2		65	2		2			
	Tregjet e energjisë	D	5	60	30/3		30/2		65	2		2			
	Logjistikë dhe menaxhim operacionesh	D	5	60	30/3		30/2		65	2		2			
	Vlerësimi pasurive të paluajtshme	D	5	60	30/3		30/2		65	2		2			
	Siguria dhe shëndeti në punë	D	5	60	30/3		30/2		65	2		2			
4.	Praktika	E	5	100	100 praktikë				25						100
5.	Mikroteza	F	30	150	150 konsultime*				600						150
<b>Gjithsej viti i dytë</b>			<b>61</b>	<b>550</b>	<b>150</b>	<b>15</b>	<b>135</b>		<b>975</b>						
<b>Total viti I+II</b>				<b>120</b>	<b>1150</b>	<b>450</b>	<b>150</b>	<b>300</b>	<b>100+25</b>	<b>1850</b>					

\*Orë të planifikuara për përgatitjen e diplomës nga studenti. Gjatë këtyre orëve (150 orë) studenti ka kontakt të vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës si dhe orë për përgatitjen individuale (600 orë).

## **8. Infrastruktura në dispozicion të programit**

### ***a. Auditorë***

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, aktualisht ka 18 auditorë për leksione me kapacitet rreth 50-100 vende dhe 24 auditorë për zhvillimin e seminareve me kapacitet 20-40 vende. Këta auditorë janë të mjaftueshëm për të përballuar numrin maksimal të studentëve të propozuar për tu pranuar në këtë master.

### ***b. Laboratorë***

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, ka 6 laboratorë infomatike me 30-60 vende. Këta laboratorë janë pajisur me kompjutera, laptop, servera, projektorë, tabela dixhitale, etj. Këto pajisje do të jenë pjesë integrale e procesit të mësimit në programin e studimit të propozuar, duke mbështetur të gjitha metodat e synuara të mësimdhënies.

Gjithashtu në kuadër të projektit K-Force një laborator i dedikuar për plotësimin e objektivave të projektit do të vihet në dispozicion të studentëve për realizimin e lëndëve të cilat kërkojnë punë në laborator. Ky mjedis do të krijohet përpara fillimit të programit Master Shkencor në Menaxhim Risku me financim nga fondet e projektit.

### ***c. Biblioteka***

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, ka 1 bibliotekë e cila është e organizuar sipas një sistemi bashkëkohor kërkimi dhe studimi. Kjo bibliotekë do të garantojë mbështetjen e programit të studimit me materiale të përditësuara, të cilat do të sigurohen nga marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet e huaja të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi. Këto materiale konsistojnë në libra mësimorë, materiale dixhitale didaktike, revista shkencore, etj.

## **9. Modeli i Diplomës dhe Modalitetet e përgatitjes, paraqitjes dhe vlerësimit të tezës së diplomës**

Modalitetet e përgatitjes dhe të paraqitjes të tezës së diplomës për programet Master Shkencor, janë të përcaktuara në “Rregulloren Mësimore të Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë” të Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

Punimi i mikrotezës presupozohet të përbëjë rezultatin e një kërkimi me origjinalitet shkencor, si nga pikëpamja e përzgjedhjes së argumentit ashtu edhe për nga metodologjia e kërkimit. Mikroteza duhet të përmbajë rreth 50-80 faqe në format A4 (me rreth 2000 karaktere në faqe). Studentit i caktohet një udhëheqës shkencor. Studenti nuk mund të mbrojë mikrotezën pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë akademike.

*Tipologjitë e temave:*

Temat e hartuara nga studentët diplomantë do të jenë në fushat e mëposhtme të menaxhimit të riskut:

- Drejtim Risku Financiar

- Drejtim Riskut i Ndërmarrjes
- Drejtim Risku Bankar
- Drejtimi i riskut të katastrofave natyrore dhe mjedisore
- Siguria dhe Shëndeti në punë
- Teoritë e vendimmarrjes;
- Sistemet e informacionit dhe ndikimi i tij në menaxhimin e riskut
- Auditimi bazuar në risk;
- Modelimi i Riskut
- etj.

Mikroteza zhvillohet nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës, i cili mban minimalisht gradën Doktor. Tema përzgjidhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin brenda semestrit të dytë të vitit të dytë. Studenti, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë ndryshimin e pedagogut udhëheqës brenda afatit të përcaktuar më lart. Platforma me bibliografinë përkatëse dorëzohet pranë Sekretarisë së Departamentit.

Për t'u pranuar në provimin e mbrojtjes së temës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit. Gjithashtu studenti nuk mund të mbrojë mikrotezën pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë akademike. Punimi dorëzohet brenda afatit të shpallur dhe publikuar nga departamenti në sekretarinë e departamenti në tre kopje. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate ose nuk kanë grumbulluar 120 kredite, nuk mund të kryejnë mbrojtjen e temës në sesionin e rregullt të diplomimit. Vetëm pasi të kenë shlyer detyrimet e mësipërme dhe të kenë dorëzuar, gjithashtu, punimin e mikrotezës, studentëve u jepet e drejta të kryejnë mbrojtjen e temës në sesionin pasardhës të diplomimit.

#### *Komisioni dhe vlerësimi*

Komisioni i vlerësimit të mikrotezës përbëhet nga 3-5 pedagogë të cilët janë të profilizuar sipas fushave përkatëse të studimit dhe tipologjive të temave të mikrotezave. Komisioni caktohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Departamentit. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh kryesisht kritere si: vlerësimi i punimit nga pedagogu udhëheqës i mikrotezës, përmbajtja e punimit, prezantimi i punimit nga studenti, etj. Kompanitë sponsorizuese mund të asistojnë në mbrojtjen e mikrotezës nga ana e studentëve.

#### *Diploma/Diplomat e lëshuara*

Në përfundim të studimeve Master, studentët do të pajisen me Diplomë “Master Shkencor në Menaxhim Risku” të lëshuar nga Universiteti i Tiranës sipas modelit të specifikuar në pikën 11 të këtij propozimi.

Modeli i Diplomës së programit të studimit dhe Suplementi i Diplomës janë bashkëlidhur këtij material.

**MIRATOHET**

**DEKANI**

**Prof. Dr. Dhori Kule**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Mynyr Koni**

**Firma, Vula**

Data \_\_\_\_\_